

AKT-THEMELIMI

I

SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Active.VR SHPK.”

Znj.Vebina Resuli e datelindjes 10.10.1984 e lindur ne Fier dhe banuese ne Tirane, e identifikuar me dokument identifikimi: leternjoftimi ID, nr personal I46010067L.

Në bazë të nenit 230/2 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Asambleja e Përgjithshme (Ortaket), sot në datën 09.02.2025 perpilon kete Akt Themelimi per themelimin e shoqërise “ACTIVE.VR SH.P.K”me përmbajtje si më poshtë vijon:

Pjesa e përgjithshme

Akti i themelimit, statuti, dhe Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, rregullojnë organizimin dhe funksionimin e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “Active.VR SHPK”.

KREU I

Emri, Forma, Zyra Qendrore, Objekti i Veprimtarisë, Kohëzgjatja, Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit, Përgjegjësia e Ortakeve

NENI 1

Emri

1.1 Shoqëria tregtare mban emrin “ACTIVE.VR SH.P.K”.

1.2 Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Ortakeve të shoqërisë.

NENI 2

Forma

2.1 Shoqëria tregtare “ACTIVE.VR SH.P.K ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3

Zyra Qendrore

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “ACTIVE.VR SH.P.K” do të ketë zyrën e saj qendrore në Shqipëri, Tiranë, Rr.e Vilave Kompleksi Sunrise residence Zona 1 Njësia 1, Nr.10

NENI 4

Objekti i Veprimtarisë

4.1 Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj tregtare në:



Shoqëria do të zhvillojë shërbime të marketingut dhe komunikimit, duke përfshirë menaxhimin dhe krijimin e rrjeteve sociale, dizajn grafik, zhvillim dhe menaxhim të faqeve web, krijimin e aplikacioneve mobile, identitetin e markës, realizimin e materialeve promocionale, fushata komunikimi, reklama audio-vizuale dhe analiza të tregut përmes sondazheve dhe studimeve.

Gjithashtu, do të merret me aktivitetin e import-eksportit dhe tregtisë me shumicë dhe pakicë të veshejeve, veshje sportive, pajisje sportive, teknologjike.

Përveç këtyre, do të përfshijë prodhimin, tregtinë e mallrave dhe shërbimeve industriale, ushqimore dhe të tjera. Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari tjetër të ligjshme që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e saj të punës. Ne fushën e menaxhimit të pronave brenda dhe jashtë territorit të vëndit.

NENI 5 ***Kohëzgjatja***

5.1 Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë “ACTIVE.VR SH.P.K” do të jetë me afat të pacaktuar.

NENI 6 ***Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit***

6.1 Shoqëria tregtare “ACTIVE.VR SH.P.K” mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7 ***Përgjegjësia e Ortakut dhe administratori***

7.1 Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë “ACTIVE.VR SH.P.K dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tij.

7.2 Administrator i shoqërisë është ortaku Znj. Vebina Resuli e datelindjes 10.10.1984 e lindur ne Fier dhe banuese ne Tirane, e identifikuar me dokument identifikimi: leternjoftimi ID, nr personal I46010067L për një periudhë 5 vjecare

KREU II ***Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat, Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit, Kalimi i Kuotave të Kapitalit***

NENI 8 ***Kapitali i Shoqërisë dhe Kuotat***

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “ACTIVE.VR SH.P.K është 10.000 lekë .

8.2 Ortake i shoqërisë është zotërues i një kuote me vlerë 10.000 lekë e cila përbën 100% të kapitalit të shoqërisë. Vebina Resuli 100%.

8.3 Kontributet që përbëjnë 100 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë janë shlyer tërësisht nga Ortakët e shoqërisë.

KREU III

Riorganizimi i Shoqërisë, Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë

NENI 9

Riorganizimi i Shoqërisë

9.1 Shoqëria mund të riorganizohet nëpërmjet bashkimit me një shoqëri tjetër, ose nëpërmjet ndarjes në dy apo më shumë shoqëri të tjera ose nëpërmjet shndërrimit të formës ligjore.

9.2 Riorganizimi i shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme (të Ortakëve).

NENI 10

Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë

10.1 Shoqëria priset në rastet e parashikuara nga ligji ose me vendim të Asamblesë së Përgjithshme (Të Ortakëve).

Në rast prishje shoqëria do t'i nënshtrohet procedurës së likuidimit.

10.2 Për procedurën e likuidimit të Shoqërisë do të aplikohet legjislacioni shqiptar në fuqi.

NENI 11

11.1 Për sa nuk është parashikuar në këtë Akt Themelimi do të aplikohen dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodit Civil dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Ky Akt Themelimi hartohet dhe firmoset në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore. Një kopje qëndron në dokumentacionin bazë të Shoqërisë.

ORTAKËT THEMELUES **Vebina Resuli**

